

# Hiqni duart nga rrogat, pensionet, liria dhe të drejtat DREJT SË ARDHMES PO MBRAPA JO

Sindikata CGIL ka deklaruar një manifestim të madh kombëtar ditën e shtunë me datën 4 prill 2009 në Romë me qëllimin që të qartësoj propozimet e saja kundër krizëz, kundër marrveshjes mbi rregullat e kontraktimit që kanë firmosur sindikatat tjera pa CGIL dhe për të thënë se **të drejta jo të barabarta = më pak të drejta për të gjithë.**

## Sepse duam:

**regullimin e punëtorëve imigrant klandestin**, për të kundërshtuar punën në të zezë dhe për të konsideruar imigracionin si një burim zhvillimi ;

**riformën e marrjes së nënshtetësisë italiane**, për të theksuar nevojën e një zgjerimi të nënshtetësisë, duke filluar tek të lindurit në Itali, për një shoqëri ndëretnike;

**të drejtën e votës administrative**, për të lënë mbrapa diskriminimet, për një shoqëri më demokratike ;

**pezullimin e ligjit Bossi-Fini në rast humbje pune për krizë të ndërmarrjes**: punëtorët imigrantë (më shumë se 2.300.000) jetojnë dhe punojnë nën respektimin e ligjeve italiane, duke prodhuar 10 % të Produkti të Brëndshëm, paguajn taksat ( më shumë se 11 miliard euro në vitin 2007) duke ndërtuar kështu të ardhmen e tyre në këtë vend; nuk është e pranueshme që, duke humbur punën, humbin edhe «Permesso di Soggiorno», duke përfunduar si klandestin me rezik largimi nga Italia ose rezik përdorjeje nga çdo pundhënës i paskrupullt;

**bashkimin familjarë**, për të mposhtur gjëndjen e vetmisë dhe të paqëndrueshmërisë të familjeve imigrante, sepse përfaqëson investimin më të mirë për të ardhmen e një imigracioni ligjor ;

**një politikë konkrete të azilit**, që respekton Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara;

**një model kontraktual**, që të garantojë dignitet të barabartë të punëtorëve në ndërmarrje.

## Sepse nuk duam:

**marrëveshjen e firmosur nga sindikatat pa CGIL mbi rregullat e kontraktimit**, që në të vërtetë ul rrogat e punëtorëve, mbrojtjet sociale, të drejtat dhe punën. Nuk garanton kontaktin e nivelit të dytë (provincial apo rajonal) në ndërmarrjet e vogla ku punojnë shumë imigrant;

**“permesso di soggiorno” me pikë**, që krijon një sistem të paqartë meritash “integrimi” dhe në rast se nuk arrihen rezikohet humbja e “permesso di soggiorno”;

**pagimin e 200 € për të rinovuar “permesso di soggiorno”**: një praktik që është detyrë e administratave shtetërore dhe e drejt për imigrantët, e cila që sot kushton 75 € dhe me kohë shumë të gjata për dorëzimin e saj dhe shpesh herë dorëzohet e skaduar;

**penalizimin e klandestinitetit**: klandestiniteti bëhet një kusht i pashmangshëm kur nuk ekziston hyrja për kërkim pune dhe duke pasur para sysh falimentimin e dekretit që parashikon programimin vjetor të flukseve;

**heqjen e mundësisë që kanë mjekët për të senjalizuar tek policia pacientët pa “permesso di soggiorno”**, për të qartësuar të drejtën për kurim që kanë të gjithë siç parashikohet nga Kushtetuta dhe nga normat ndërkombëtare dhe për mbrojtjen e shëndetit të kolektivitetit;

**grupet e shtetasëve për ruajtjen e rendit (ronde) në lagjet e komunave**, për të mos ndarë banorët, për të mos krijuar friksime të papërshtatshme, për të mos zëvendësuar rolin e Shtetit.

Për të marrë pjesë drejtoju CGIL së qytetit tënd

Komiteti Kombtarë i Imigrantëve CGIL